

NE JEMI



TË BASHKUAR

DEMOKRACIA DHE BASHKËPUNIMI

RIGON (9), OLTİ (9), MEDINA (9), KRENARE (9), BLINERA (9), LINA (9), ULVI (9), ALBESA (9)

Toleranca, paqja dhe mirësjellja

Demokracia është një lloj qeverisje në të cilën njerëzit e ushtrojnë sovranitetin e tyre. Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke që do të thotë „demos“ popull dhe „kratos“ udhëheqësi ose rend.

Demokracia lindi në vitin 507 para erës sonë.

Sa shumë të drejta kemi ne? Ne kemi të drejtë të jemi të lirë, të shkollohemi, të japim mendimet tona, të luajmë, të edukohemi, të mësojmë, të shikojmë televizion, etj. Ne duhet të shoqërohemi me të gjithë, të kemi respekt ndaj njëri-tjetrit, të kemi dashuri e mirësjellje, ne duhet t'i dëgjojmë prindërit, etj.

Elementet e demokracisë janë: liria, paqja, toleranca dhe barazia. Prandaj, ne nuk duhet të ndahemi nga njëri-tjetri dhe duhet të jemi të lirë.

Janë dy lloje të demokracisë: e drejtëpërdrejtë dhe përfaqësuese. Te ajo përfaqësuese, populli me anë të votave zgjedh udhëheqësin. Dhe kur ne votojmë duhet të kemi të drejtë të votojmë për atë që duam.


Ne të gjithë kemi të drejtë të bëhemi gazetarë.

Dhe sot për herë të parë, ne kemi pasur fatin që të bëhemi gazetarë të demokracisë për Kuvendin e Republikës së Kosovës.


Pra, demokracia ka të bëjë me shprehjen e lirë të mendimit.

Ne si fëmijë duhet t'i bëjmë punët së bashku dhe të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin.


Ka disa njerëz që bëjnë vepra të këqija, por ne nuk duhet të veprojmë ashtu, sepse ne duhet të kemi sjellje të mirë.




Mirësjellja në demokraci



Votat tona



Ja se si mund të jemi qytetarë aktiv



Të drejtat e fëmijëve në demokraci



Respekti është element i rëndësishëm në demokraci



Zgjedhjet e fëmijëve gjatë jetës së përditshme



Ne bëjmë zgjedhje të ndryshme çdo ditë



Mendimet e fëmijëve për qytetarinë aktive



Ne kemi të drejtë të zgjedhim kafshët tona shtëpiake



Ne zgjedhim veprimet tona dhe shokët tonë

ZGJEDHJET E FËMIJËVE

ENDRITA (9), ERA (9), ESMA (9), MUSLIU (10), VITA (9), ANDIK (9), FLORENTINA (10)



Vendi ynë, Kosova na mundëson neve fëmijëve të jetojmë të lumtur me familjet tona


Grupi „Rrushi“, sot ka diskutuar për temën e zgjedhjeve, çka janë zgjedhjet, si ndahen zgjedhjet dhe pse janë të rëndësishme për ne si fëmijë, si dhe për çdo qytetar. Së pari, ne diskutuam për zgjedhjet që ne si fëmijë i bëjmë. Ne si nxënës të klasës së katër si shembull të zgjedhjeve e morëm si ne e zgjedhim kryetarin e klasës. Në fillim, ne i kemi propozuar disa shoqe dhe shokë tonë, pastaj kemi votuar për ta. Pasi të gjithë nxënësit votuan, ne filluam t'i numërojmë votat dhe fitues doli njëri nga nxënësit që mori më së shumti vota.

Këto zgjedhje që ne si nxënës i bëjmë janë të ndryshme nga ato që qytetarët më të rritur i bëjnë. Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare e votojnë kryetarin e komunës si dhe asambleistët, e këto lloj zgjedhjesh ku votohet për kryetarin e komunës quhen zgjedhje komunale. Ndërsa, zgjedhjet e deputetëve quhen zgjedhje qendro-

re, ku deputetet kanë mandat katër vjeçar, dhe që de-tyra e tyre është ta përfaqësojnë popullin. Ne si nxënës ende nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në këto lloje të zgjedhjeve që i cekëm më lartë, sepse ende nuk e kemi arritur moshën adekuate. Pra, ne kur të rritemi dhe ta arrijmë moshën 18 vjeçare do të votojmë për atë që neve na duket më i miri.



Ne shpresojmë që çdo njeri që është duke lexuar këtë artikull të mësoj diçka për zgjedhjet. Ju duam shumë, grupi i „Rrushit“.



Në këtë punim kemi paraqitur dy llojet e zgjedhjeve



Grupi „Rrushi“ duke punuar për temën e zgjedhjeve

QYTETARËT DHE KOMUNITETI

ALBINOT (9), LIBURN (10), ADNI (9), DIJONA (9), ELDA (9), RIAD (9), DIOR (9), ELZA (9)

Ne qytetarët dhe nxënësit e klasës IV-3 nga shkolla „Nazim Gafurri“ nga Prishtina dëshirojmë t’iu tregojmë për gjërat që kemi mësuar për demokracinë dhe qytetarinë aktive


Demokracia është udhëheqja e popullit, ku të gjithë njerëzit i gëzojnë të drejtat e barabarta. Ne kemi mësuar se të gjithë njerëzit kanë të drejta dhe përgjegjësi për njëri-tjetrin. Të jesh qytetar, do të thotë të jesh i regjistruar në regjistrin civil të vendit tënd.

Ne si gazetarë, mësuar se duke qenë qytetarë aktiv duhet të kujdesemi për ambientin ku jetojmë, të pastrojmë shtëpinë tonë, ambientin e klasës sonë, të dalim të votojmë kur t’i mbushim 18 vjeç, të mësojmë dhe të bëhemi më të mençur, si dhe ta pasurojmë mendjen tonë. Pra, të gjithë qytetarët kanë të drejtat e veta dhe përgjegjësitë e tyre, të cilat ne duhet t’i zbatojmë dhe t’i respektojmë.

Ne duhet të jemi aktiv, sepse duhet ta ndërtojmë demokracinë e vendit tonë.



Demokracia na bën të lumtur!




Mendimet tona si qytetarë aktiv



Ne, gazetarët e qytetarisë aktive



Gjethja ime



Shtëpia e „Qytetarisë Aktive“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë